




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



	Data 28.03.23	Vendi KACANIK
Nj. org.	Numri	Shtojce
01	109/02-7536	/.

Kaçanik, 28.03.2023

Duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me numër 09-660/01-4005/23 të miratuar më datë 27.02.2023, vendimit të MAPL me numër -VI-020-202/4 i datës 24.03.2023 dhe rregullorës MF-NR-04/2017, Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall këtë :

### Thirrje Publike

Për mbështetje financiare, për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kontribuojnë në promovimin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit sipas rregullorës MF-NR-04/2017

1. **Komuna e Kaçanikut/ Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit** u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Registruara në Republikën e Kosovës e që veprojnë në Komunën e Kaçanikut, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet sipas kësaj thirrje publike.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/ programet e tyre përfshirë prioritare në Kulturë, Rini dhe Sport .

3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në promovimin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes aktivitetave si më poshtë:

#### 4. NË FUSHËN E KULTURËS

- Promovimi dhe afirmimi i vlerave kulturore
- Promovimi i krijimtarisë lokale artistike
- Promovimi i trashëgimisë kulturore
- Festivalet, koncertet, shënimet e datave historike e kulturore, simpoziumet dhe ekspositat
- Përkrahja për grupet/shoqëritë kulturo-artistike që funksionojnë në komunën e Kaçanikut, do të mbështeten bazuar në realizimin e sukseshëm të programeve të tyre kulturore dhe artistike në vitet paraprake dhe planprogramit të tyre të punës për vitin 2023

#### **4 NË FUSHËN E RINISË DHE SPORTIT**

- Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave rinore në zhvillimin e aktiviteteve specifike për të rinjë që ndikojnë drejtësuaritë në nxitjen e aktiviteteve në fushat e ndryshme të përfshirë në strategjinë kosovare për rini dhe plan të veprimit;
- Promovimi i vullnetarizimit ;
- Përkrahja e klubeve publike sportive;
- Përkrahja e sportistëve kulmore dhe klubeve të suksesshme;
- Avancimi i aktiviteteve në klubet sportive dhe masovizimi i sportit për të rinjë ;
- Aktivitete me simpatizantë me qëllim të parandalimit të dhunës dhe dukurive negative në sport
- Përkrahja për klubet që funksionojnë në komunën e Kaçanikut do të mbështeten bazuar në realizimin e suksesshëm të aktiviteteve/programeve të tyre rinore e sportive në vitet paraprake dhe planprogramit të tyre të punës për vitin 2023.

#### **4.1 Aktivitetet sipas planit të punës për vitin 2023 në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

- Organizimi i aktivitetetët sipas planprogramit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për shënimin e datave të rëndësishme vendore, kombëtare e ndërkombëtare.

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes publike në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është **68.000.00€**

##### **4.1 Kulturë, 19.500.00€**

###### **4.1.1 Organizimi i Festivalit Kombëtar të SHKA-ve dhe Ansambleve Kulturo-Artistike---- 6,000.00 €**

Përfituesi për organizimin e festivalit do të kujdeset që:

- Festivali të jetë 2 ditor
- Të sigurohet hapësira e mbajtjes së Festivalit
- Të rregullohet skena dhe bani (pano) me mbishkrime
- Të kujdeset për organizimin e festivalit me moderim, sigurim, fotograf profesional
- Të bëhet defilim i SHKA-ve
- Të sigurohen 8 SHKA nga mbrenda dhe jashtë Kosove (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Lugina e Preshevës dhe nga Mali I Zi)
- Të sigurohet teknika e ndriçimit dhe zërimi
- Të sigurohet restoranti (hoteli ) për akomodim (1 natë fjetje, për pjesëmarrësit nga jashtë ) dhe ushqim të SHKA-ve mysafire
- Të përgatiten dhe të shpërndahen ftesat dhe njostimet me kohë
- Të sigurohen çmimet e festivalit për vendet fituese (precizohen në projekt)
- Të sigurohet juria e festivalit
- Të performojnë me nga një pikë SHKA-të vendase (jashtë konkurencës së garës )

#### **4.1.2 Organizimi i Festivalit të Këngës Popullore për Fëmijë “Kaçaniku Këndon”----- 4,000.00€**

Përfituesi për organizimin e festivalit do të kujdeset që:

- Festivali të jetë 3 ditor
- Të sigurohet hapësira e mbajtjes së Festivalit
- Të kujdeset për organizimin e festivalit me moderim, sigurim, fotograf professional
- Të rregullohet skena dhe baneri (pano) me mbishkrim
- Të sigurohen deri në 40 fëmijë që do të performojnë në festival në bashkëpunim me shkolla
- Të sigurohet teknika e ndriqimit dhe zërimi
- Të sigurohet restoranti për ushqim pjesëmarrësit dhe mysfirët
- Të përgatiten dhe të shpërndahen ftesat dhe njoftimet me kohë
- Të sigurohen çmimet e festivalit (precizohen në projekt)
- Të sigurohet juria e festivalit

#### **4.1.3 Organizimi i Aktivitetit për mërgimtarë “Ju jeni pjesë e Atdheut”----- 2,000.00€**

Përfituesi për organizimin e aktivitetit do të kujdeset që :

- Të sigurohet hapësira për mbajtjen e programit kryesor
- Të kujdeset për organizimin e festivalit me moderim, sigurim, fotograf professional
- Të rregullohet skena
- Të bëhen njoftimet, ftesat dhe shpërndarja e tyre me kohë
- Të sigurohet program kulturo-artistik nga gjitha zhanret e muzikës dhe të ftohen të gjitha SHKA-të, dhe gjitha Rock -grupet kaçanikase për performim.
- Të sigurohet një koktej rasti

#### **4.1.4 Aktivitetet Sipas Planprogramit të OJQ/ve ----- 7,500.00€**

- Organizimi i aktivitetetë sipas planprogramit të punës të SHKA-ve/ OJQ-ve për vitin 2023, duke u bazuar në objektivat e kësaj thirrje në lëminë e kulturës .

### **4.2 Rini dhe Sport, 44,500.00 €**

#### **4.2.1 Aktivitetet Sipas Planprogramit/garave të Klubeve/ OJQ-ve - ----- 44,500.00€**

- Organizimi i aktivitetetë sipas planprogramit të punës të klubeve/ OJQ-ve për vitin 2023 duke u bazuar në objektivat e kësaj thirrje në lëminë e rinisë dhe sportit .

### **4.3 Aktivitete sipas planit të punës së DKRS-së 4,000.00€**

#### **4.3.1 Dita Botërore e të moshuarve ----- 2,000.00€**

Përfituesi për organizimin e aktivitetit do të kujdeset që :

- Të sigurohet hapsira për mbajtjen e aktivitetit
- Të rregullohet Pano me mbishkrim për aktivitetin
- Të bëhen njoftimet, ftesat dhe shpërndarja e tyre me kohë
- Të sigurohet program kulturo-artistik me të gjitha SHKA-të vendase .
- Të sigurohet një koktej rasti
- Dhe aktivitetet tjera për të moshuarit gjatë vitit

#### **4.3.2 Aktivitetetë kulturore ----- 1,000.00€**

Përfituesi për organizimin e aktivitetetëve do të kujdeset që të organizojë :

- Shënimin e 10 Gushtit/Dita e Dëshmorëve
- Shënimin e Javës së Rinisë
- Shënimin e 11 Qershorit/Dita e Çlirimt të Kaçanikut
- Shënimin e aktivitetetëve të Festave të Nënëtorit

#### **4.3.3 Aktivitete Rinore e Sportive ----- 1,000.00€**

Përfituesi për organizimin e aktivitetave do të kujdeset që të organizojë :

- *Shënimin e ditës ndërkombe të fëmijëve*
- *Shënimin e ditës botërore të sportit dhe ambientit*
- *Shënimin e javës Europiane të Sportit*
- *Shënimin e 11 Qershorit/ Dita e Çlirimtës së Kaçanikut (aktivitete sportive)*
- *Shënimin e 10 Gushtit/ Dita e Dëshmorëve(aktivitetet sportive )*
- *Shënimin e javës së Rinisë (aktivitete sportive )*

#### **5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datë **24.04.2023****

OJQ-të mund të aplikojnë me projekt në kuadër të kësaj thirje, në secilën fushë :Kulturë, Rini apo Sport sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është për deri në përfundimin e vitit 2023. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruar në regjistrin e organizatave jo- Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Kaçanikut. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit . OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislaconit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare publike .

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se **personi përgjegjës në OJQ** dhe **menaxheri i projektit** nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

**6. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit ( shkarko aplikacionin <http://kk.rks-gov.net/kacanik>) në faqen e internetit të komunës së Kaçanikut.**

*Kliko : [SHPALLJET ----APLIKACIONET ----FORMULARI PËR APLIKIM - KULTURE, RINI, SPORT](#)*

**7. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimi të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirje publike, dhe të cilat i përbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.**

**8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [hafize.sallahi@rks-gov.net](mailto:hafize.sallahi@rks-gov.net)**

#### **Kërkesës së aplikimit duhet ti bashkangjiten edhe dokumentet :**

- Certifikata e numrit të regjistrimit të organizatës;
- Certifikata e numrit fiskal të organizatës;
- Vërtetimi i regjistrimit pranë Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kaçanik;
- Vërtetimi i regjistrimit pranë Federatës Përkatëse (vetëm për klubet- niveli garues);
- Letërnjoftimi i personave (aplikantit) që përfaqëson organizatën dhe menaxherit të projektit ;
- Xhirologaria dhe dëshmia e bankës në emër të organizatës, më i ri se 3 muaj ;
- Dëshmi se organizata nuk ka obligime ndaj ATK-së ;

Dokumentacioni i cili shkarkohet nga web faqja e Komunës së Kaçanikut :

1. Formulari i aplikacionit për projekt programin
2. Formulari i propozim buxhetit
3. Formulari i deklaratës së financimit të dyfishtë
4. Forma e deklaratës së projekteve fë financuara

**Data e aplikimit: 29.03.2023 deri më 24.04.2023**

Dorëzimi i aplikacioneve : **Objekti i Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5)**  
Komuna e Kaçanikut do të formojë një komision profesional për vlerësimin e projekteve dhe rezultatet do të jenë publike për secilën OJQ aplikuese, të detajuara sipas rregullorës MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve .

